REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ**
**KRYETARI**

Nr. 3778 Prot  Maliq, më 17. 6 .2026

**PROJEKT-VENDIM** - NR. 11

**"PËR IDENTIFIKIMIN E PASURISË TË SHËNUAR X NË FSHATIN SELCË"**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" , i ndryshuar, neni 64, "*Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë", gërma c*, neni 54 "*Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak*", Ligjit nr. 107/2014 për "*planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", neni 12, "*Përgjegjësitë e këshillit bashkiak",* Kërkesës Nr.3332 prot, datë 29.05.2026 të Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave,

**PROPOZOJMË:**

1. Të miratohet nga Këshilli Bashkiak kërkesa për tu pajisur me numër pasurie X sipas dokumentacionit teknik dhe hartës kadastrale, është konstatuar se një sipërfaqe prej 1691 m². aktualisht e përfshirë në pasurinë nr. 789 të regjistruar në llojin "pyll", përfaqëson në fakt rrugë ekzistuese që lidh fshatin Selcë me zonat përreth. Kjo rrugë kufizohet në veri me pasurinë nr. 53 dhe në jug me pasurinë nr. 536/17, e regjistruar si rrugë.

2. Ky vendim hyn në fuqi sipas percaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë.

Konceptoi: J. Thomo Dt. 17 / 6 /2026

Topograf/Kadastër: M. Lame Dt. 17 / 6 /2026

Drejtor D.P.P.A: J. Sulo Dt. 17 / 6 /2026

**KRYETARI I BASHKISË**
**Gëzim Topçiu**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ**
**KRYETARI**

3778

Maliq, më 17. 6. .2026

**Lënda:** Për fillimin e procedurave për identifikimin e pasurisë të shënuar x në fshatin Selcë.

**Drejtuar:** **Këshillit të Bashkisë Maliq**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" , i ndryshuar, neni 64, "*Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë", gërma c*, neni 54 "*Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak*", Ligjit nr. 107/2014 për "*planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", neni 12, "*Përgjegjësitë e këshillit bashkiak",* Kërkesës Nr.3332 prot, datë 29.05.2026 të Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave, me anë të se ciles kerkohet nje të pajiset me numër pasurie rruga, sipas dokumentacionit teknik dhe hartës kadastrale, është konstatuar se një sipërfaqe prej 1691 m², aktualisht e përfshirë në pasurinë nr. 789 të regjistruar në llojin "pyll", përfaqëson në fakt rrugë ekzistuese që lidh fshatin Selcë me zonat përreth.

Kjo rrugë kufizohet në veri me pasurinë nr. 53 dhe në jug me pasurinë nr. 536/17, e regjistruar si rrugë. Inventarizimi i kësaj rruge kërkohet për arsye funksionale dhe administrative, pasi rruga përdoret aktualisht nga banorët, vizitorët dhe strukturat operacionale që veprojnë në zonën pyjore. Ajo ka rëndësi të veçantë për:

- garantimin e aksesit në fondin pyjor;
- ndërhyrjen e shpejtë të mjeteve dhe forcave operacionale në rastet e zjarreve;
- mbrojtjen dhe administrimin e qëndrueshëm të fondit pyjor;
- zhvillimin e turizmit natyror dhe malor në zonë.

Nga verifikimet në terren dhe dokumentacioni i administruar, rezulton se sipërfaqja në fjalë nuk përdoret si fond pyjor, por si infrastrukturë rrugore ekzistuese. Për këtë arsye kërkohet pasqyrimi i saj në hartën kadastrale si pasuri e veçantë dhe regjistrimi në llojin e pasurisë "rrugë".
Miratimi i këtij projektvendimi do të mundësojë përputhjen e gjendjes faktike me regjistrimin kadastral, përmirësimin e administrimit të pronës publike dhe garantimin e funksionalitetit të kësaj infrastrukture në shërbim të komunitetit dhe zhvillimit të zonës.

Për sa më sipër, propozojmë miratimin e inventarizimit dhe regjistrimit të sipërfaqes prej 1691 m² si pasuri "rrugë", sipas dokumentacionit teknik bashkëlidhur.

Konceptoi: J. Thomo Dt. 17 / 6 /2026

Drejtor D.P.P.A: J. Sulo Dt. 17 / 6 /2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

**KRYETARI I BASHKISË**

**Gëzim Topçiu**

# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI:SHTET | DATE 16.06.2026 | QELLIMI REGJISTRIM


VENDNDODHJA
BASHKIA MALIQ | DVASHK/ZVASHK KORCE | ZONA KADASTRALE:3279 | NUMRI PASURISE 789 | INDEX HARTES K-34-114-(178-D)

TE DHENAT E PASURISE
LLOJI PASURISE:PYLL | SIP.PASURISE=18879m2 | SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT_m2 | NUMRI KATEVE 0 | NUMRI PEMEVE

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X 545880.73
Y 4514148.66

X 546538.73
Y 4514148.66




X 545880.73
Y 4513551.66

SH 1:2500

X 546538.73
Y 4516551.66

| Nr. | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZUESIT |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | VERI | | NR PASURIE | 753 | | |
| 2 | LINDJE | | NR PASURIE | 789 | | |
| 3 | JUG | | NR PASURIE | 789 | | |
| 4 | PERENDIM | | NR PASURIE | 536/17 | | |

REALIZOI PER BASHKINE MALIQ
TOPOGRAF:Mevlan LAME
NENSHKRIMI

MIRATOI
DREJTOR: Johand SULO
NENSHKRIMI

KONFIRMOI
KRYETARI I BASHKISE:Gezim TOPÇIU
NENSHKRIMI / VULA _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T, Z, O, D
Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT: P; HK
Kode per percaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve;K-Kufitarët të Gjithë K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:
Pasuria X me sipërfaqe 1691m2 e pasqyruar në hartën kadastrale me ngjyrë jeshile, përfshihet tek pasuria nr.789 e regjistruar në llojin e pasurisë pyll. Në fakt sipërfaqja prej 1691m2 është rrugë e cila bashkohet në veri me pasurinë nr.753 dhe në jugë me pasurinë nr.536/17, të regjistruara rrugë. Në këto pasuri kalon rruga që lidh fshatin Selcë me fshatin Velçan.
Kërkohet pasqyrimi i kësaj sipërfaqe në hartën kadastrale si pasuri e veçantë dhe regjistrimi në llojin e pasurisë rrugë.